



KOMUNITET Printo këtë faqe · Shpreh mendimin tuaj... 0 koment(e)

Ky artikulli u publikua online më 26 Sep 2008

Projekt shtëpish për viktimat e martesave me forcë

Nga: [Junaid Bhati](#)

Një iniciativë e re që synon të sigurojë ndihmë për viktimat e dhunës dhe martesës me forcë është vënë në përdorim në Birmingham. “Mbështetja dhe Shtëpitë” është një projekt karitasi që siguron akomodim dhe ndihmë për viktimat, dhe aktualisht ka siguruar mbështetje nga “Bashkësia e Policëve që mbështesin të dhunuarit e kësaj kategorie”, “Shërbimi Gjyqësor” dhe Bashkisë lokale. Sipas Junaid Bhatit, drejtor i Balencrief House, vendimi i “Throughcare Housing and Support” do të shënohet si pikënisje nga një eveniment tip ‘gala’, në “Second City Suite” në Birmingham, gjatë këtij muaji. Grupi Pop “Saqi Live” do të performojë në këtë eveniment bashkë me trupën e valleve “Nachda Sansar”. Në këtë eveniment do të jenë të ftuar edhe grupe nga etnicitetit e ndryshme dhe nga shqiptarët e Kosovës dhe Shqipërisë që veprojnë në zonë. Iniciativa “Throughcare” është një ide e gruas së suksesshme të biznesit, Kelly Kaur, që vetë ajo ka patur një eksperiencë të mospasjes së shtëpisë, duke refuzuar që të marrë pjesë në një martesë me forcë. Ajo është e vendosur në idenë e saj se gratë e martuara me forcë dhe të dhunuara kanë nevojë për ndihmë fizike dhe emocionale që të harrojnë stresin dhe eksperiencat negative. Kelly shpjegon: “duke krijuar vëmendje dhe edukim të komuniteteve, sit ë burrave dhe grave të të gjithë moshave, ne kemi armatosur njerëzit me njohuri që at ate jenë në gjendje ti përballojnë vështirësitë e tyre. “Throughcare Housing and Support” ndihmon viktimat që të rikthehen në jetën normale dhe u garanton ndihmë emocionale që të kryejnë shërbim të vlefshëm në shoqëri”. Ajo shton: “është totalisht e pakonceptuar që në ditët tona të vazhdojë praktika të padëshiruara njerëzore që injorojnë të drejtat njerëzore dhe individuale. Kjo është pra ajo që ne synojmë të arrijmë duke luftuar përfituesit e një mendësie të shkuar dhe ndihmuar mendësitë e reja të shoqërisë ku ne jetojmë bashkërisht”.